REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT TË ENERGJISË DHE INDUSTRISË**
**DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E ENERGJISË DHE EFIÇENCËN E ENERGJISË**

Nr. 218/5 Prot. Tiranë, më 29/10/2021

Lënda: Dërgim shtesë kontrate.

**AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë

Për dijeni: **AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KONCENSIONEVE (ATRAKO)**
Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, Tiranë

Në zbatim të VKM Nr. 504 datë 13.09.2017 *"Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë"* dhe Urdhrit të Kryeministrit Nr. 72 datë 27.04.2018 *"Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë"*, si dhe në kuadër të realizimit të objektivave të miratuara të institucionit tonë, bashkëlidhur po ju dërgojmë bashkëlidhur Kontratën shtesë të Koncesionit Nr. 8929 Rep. dhe Nr. 2870 Kol. datë 20.10.2021 *" Për disa ndryshime në Kontratën e Koncesionit të formës BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e Hidrocentralit "Kacni"* me zhvillues shoqërinë "Kisi-Bio Energji" sh.p.k., për njohje dhe disponim, në kuadër të monitorimit nga ana juaj, në zbatim të VKM-së Nr. 547, datë 09.08.2006, të ndryshuar,

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Vi

A2021053950312418488

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR. 8929 Rep.
NR. 2870 Kol.

## KONTRATË SHTESË KONCESIONI

## PËR
## DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS "BOT"
## (NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM)
## PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT "KACNI"

Në Tiranë, më datë 20, muaji Tetor, viti 2021 (dymijë e njëzetë e një), para meje noter , anëtar i dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë , u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar me autorizim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. , datë (kopje bashkëlidhur) nga Z. Jetir Pepa , i datëlindjes , madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Letërnjoftim ID

DHE

Shoqëria **"Kisi – Bio-Energji"** sh.p.k, themeluar si person juridik datë 08.02.2011 dhe regjistruar në QKB datë me NUIS , përfaqësuar ligjërisht nga administratori e shoqërisë Z. Julian Çela, i datëlindjes , madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta me ID dhe nga znj. Ardita Rama e datëlindjes , madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u sigurova nga ID,

**të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:**

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë Koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së Koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim) për ndërtimin e hidrocentralit "Kacni", me Nr. 993 Rep., Nr. 179 Kol., lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe shoqërisë "KISI" sh.p.k (Koncesionari), më datë 05.05.2008, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 568, datë 07.05.2008, e ndryshuar, me Kontratën shtesë Nr. 58 Rep., Nr. 17 Kol., datë 24.01.2012 "Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës "BOT" për ndërtimin e hidrocentralit "Kacni", me kontratën shtesë Nr. 241 Rep., Nr. 124 Kol., datë 25.03.2013 "Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim) për ndërtimin

A2021053950312415455

e hidrocentralit "Kaeni", dhe Kontratën shtesë Nr. 319 Rep., Nr. 160 Kol., datë 04.06.2014 "Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim) për ndërtimin e hidrocentralit "Kaeni".

## Hyrje

**Duke pasur parasysh që:**

- Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoriteti Kontraktues) dhe shoqërisë "KISI" sh.p.k (Koncesionari) është lidhur Kontrata e Koncesionit e formës "BOT" me Nr. 993 Rep., Nr. 179 Kol., datë 05.04.2008 për ndërtimin e hidrocentralit "Kaeni", miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 568, datë 07.05.2008, (në vijim referuar si **Kontrata e Koncesionit**), e ndryshuar me
- Kontratën shtesë Nr. 58 Rep., Nr.17 Kol., datë 24.01.2012 "Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës "BOT" për ndërtimin e hidrocentralit "Kaeni";
- Kontratën shtesë Nr. 241 Rep., Nr. 124 Kol., datë 25.04.2014 "Për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim) për ndërtimin e hidrocentralit "Kaeni".
- Kontratën shtesë Nr. 319 Rep., Nr. 160 Kol., datë 04.06.2014 "Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim) për ndërtimin e hidrocentralit "Kaeni".
- Shoqëria koncesionare "Kisi Bio Energji" sh.p.k me shkresë Nr. 33 Prot datë 18.12.2020 "*Dërgohet për miratim projekti i zbatimit të rishikuar të Hec Kaeni*" protokolluar në MIE me Nr.8885 Prot datë 18.12.2020 paraqiti në MIE për oponencë dhe miratim, Projektin e Zbatimit të rishikuar për hidrocentralin "Kaeni" dhe në vijim, MIE me shkresën Nr. 218 Prot. datë 07.01.2021 ka dërguar pranë AKBN-së për kryerjen e oponencës teknike, projektin e zbatimit të rishikuar të hidrocentralit "Kaeni";
- AKBN me shkresën Nr. 86/4 Prot. datë 09.03.2021 "*Dërgohet raporti i oponencës teknike mbi projektin e zbatimit të ndryshuar Hec-it "Kaeni"*", të shoqërisë koncesionare "Kisi Bio Energji" sh.p.k. dërgon në MIE oponencën teknike për miratim:

  Sipas konkluzionit përfundimtar të Oponencës Teknike, paraqitur nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore me shkresën Nr. 86/4 Prot. datë 09.03.2021, protokolluar në MIE Nr.218/1Prot datë 09.03.2021, Autoriteti Kontraktues me shkresën Nr. 218/2 Prot., datë 18.06.2021 "*Miratohet projekti zbatimit i ndryshuar i HEC-it "Kaeni"*" drejtuar shoqërisë "Kisi Bio Energji" sh.p.k. ka miratuar projektin e zbatimit duke theksuar se shprehet e gatshme për të nënshkruar kontratën shtesë të koncesionit ku do të pasqyrohen ndryshimet e parametrave hidroenergjitike, në përputhje me projektin e zbatimit të ndryshuar, duke i kërkuar shoqërisë preventivat përmbledhës të punimeve (4) kopje dhe sigurimin e kontratës, për vlerën e investimit sipas këtij projekti zbatimi të miratuar nga Autoriteti Kontraktues;
- Shoqëria "Kisi Bio Energji" sh.p.k. me shkresë Nr. 55 Prot datë 02.07.2021 "*Paraqitje dokumentacioni në vijim të shkresës së dërguar nga MIE*" protokolluar në MIE me

A20210539503124154SS

Nr.218/3 Prot. date 02.07.2021 ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar duke konfirmuar gatishmerine e shoqërisë për të lidhur kontraten shtese të koncesionit;

- Në nenin 19 "Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit" te Kontrates se Koncesionit, parashikohet se Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari jane zotuar të bashkëpunojnë ne mënyre që te garantojnë realizimin e plote te projektit.

Ne Kontraten e Koncesionit te formes "BOT" (Ndertim - Operim - Transferim) me Nr. 903 Rep., Nr. 179 Kol., date 05.05.2008, lidhur ndermjet Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe shoqerise "KISI" sh.p.k (Koncesionari), për ndërtimin e hidrocentralit "Kacni", miratuar me VKM Nr. 568, date 07.05.2008, te ndryshuar, të behen ndryshimet e meposhtme:

**Neni 1**

Në nenin 1 *"Perkufizime dhe interpretime"*,

Në piken 1.2 Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes e zëvendësuar me togfjaleshin "Ministria e Energjisë dhe Industrisë" zëvendesohet me "Ministrine e Infrastruktures dhe Energjise"

Ne pikën 1.4, shprehja *"... me fuqi te instaluar 1100 (nje mijë e njëqind) kW dhe prodhim te energjisë elektrike 7,189,380 kWh (shtate milionë e njëqind e tetëdhjetë e nentëmijë e treqind e tetedhjete)"*, zëvendësohet me shprehjen: *"me fuqi të instaluar 4670 kW (katërmijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) dhe prodhim të energjise elektrike 7,823,826 KWh (shtate milion e teteqind e njezet e tre mijë e teteqind e njëzet e gjashte)"*

**Neni 2**

Neni 5, *"Detyrimet dhe të drejtat e koncesionarit"*, pika 5.12 ndryshohet si më poshte:

- Te zbatoje projektin për ndertimin e HEC-it Kacni me fuqi te vendosur prej 4670 kW.

**Neni 3**

Ne nenin 18 *"Sanksionet"*, ne piken 18.4 zevendesohet me shprehjen "Ne rast mosrealizimi për faj te koncesionarit te prodhimit te energjise elektrike prej 7,823, 826 kWh, Koncesionari penalizohet me 5% te vlerës së prodhimit te parealizuar per periudhen raportuese".

**Neni 6**

Kjo Kontrate Shtese koncesioni hyn ne fuqi pas nënshkrimit nga palët.

Kontrata Shtesë e Koncesionit u hartua në 5 (pesë) kopje dhe pas [illegible] palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë, [illegible] e vërtetojnë atë rregullisht sipas ligjit.

## PALËT

| AUTORITETI KONTRAKTUES | SHOQËRIA KONCESIONARE |
|---|---|
| Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | "KISI – BIO - ENERGJI" Sh.p.k |
| Përfaqësuar me Autorizim Nr.[illegible], datë [illegible] të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nga: | Përfaqësuar nga: |
| — | Z.<br>ADMINISTRATOR |